REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr. 5562 Prot Maliq, më 21.10.2025

PROJEKT-VENDIM -VKB 180

Për

Miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rënëve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr. 778, zk. 2445, fshati Libonik, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 114/80, zk. 2445, fshati Libonik

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 23, pika 14, nenit 25, pika 1 dhe 2, nenit 54, Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, si dhe shkresës nr. 329 prot., datë 20.10.2025 "*Kërkesë për zhvendosjen e lapidarit në fshatin Libonik*", të Njësisë Administrative Libonik,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rënëve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr. 778, zk. 2445, fshati Libonik, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 114/80, zk. 2445, fshati Libonik.
2. Arsyeja e zhvendosjes të lapidarit është për shkak të mos patjes akses në vendodhjen aktuale, si rrjedhojë e pozicionimit midis pasurive pronë private.
3. Bashkia Maliq të marrë të gjitha masat teknike dhe financiare për zhvendosjen dhe rivendosjen e objektit në përputhje me normat për ruajtjen e integritetit të tij.
4. Projekt-vendimit i bashkëlidhet plani i rilevimit dhe planvendosja e pasqyrimit të vendodhjes aktuale të lapidarit, dhe pasurisë nr. 114/80 (Pronar: Shteti), ku parashikohet të zhvendoset lapidari.
5. Ngarkohen Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Agjencia e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Maliq, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 20/10/2025

Topograf/Kadastër: M. Lame Dt. 20/10/2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 20/10/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.5562 Prot Maliq, më 21.10.2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin "*Për miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rënëve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr. 778, zk. 2445, fshati Libonik, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 114/80, zk. 2445, fshati Libonik*"

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-Vendimi "*Për miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rënëve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr. 778, zk. 2445, fshati Libonik, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 114/80, zk. 2445, fshati Libonik*", mbështetet në Ligjin Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 23, pika 14, nenit 25, pika 1 dhe 2, nenit 54, Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar.

Nga banorët e fshatit Libonik dhe Drithas, por dhe së fundmi nga Njësia Administrative Libonik me shkresë nr. 329 prot., datë 20.10.2025 "*Kërkesë për zhvendosjen e lapidarit në fshatin Libonik*", protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 5542 prot., datë 20.10.2025, duke patur vështirësi për akses si rrjedhojë e pozicionimit në disa pasuri private, është kërkuar zhvendosja e lapidarit në fshatin Libonik.

Nga verifikimi që është kryer në terren nga specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Aseteve, rezulton që lapidarit përkujtimor të të rënëve të luftës, ndodhet aktualisht në pasurinë nr. 778, zk. 2445, fshati Libonik, dhe zhvendosja është parashikuar në pasurinë në pasurinë nr. 114/80, zk. 2445, fshati Libonik, pasuri me pronar shtet, si vendndodhje me e përshtatshme.

Mbi verifikimet e kryera është përgatitur plani i rilevimit dhe planvendosja e pasqyrimit të vendodhjes aktuale të lapidarit, dhe pasurisë nr. 114/80 (Pronar: Shteti), ku parashikohet të zhvendoset lapidari, të cilët gjenden bashkëlidhur projekt-vendimit.

Për sa më sipër në kompetencën Tuaj, kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 20/10/2025

Topograf/Kadastër: M. Lame Dt. 20/10/2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 20/10/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

BASHKIA MA
Zy e Protol
Nr.5542 Prot.....
Date 20.10.25 Nenshkrimi

-D. Pronave
dt 20.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBONIK
ADMINISTRATORI

Nr.329 Prot Libonik më: 20/10/2025

Lënda : Kërkesë për zhvendosjen e Lapidarit në Fshatin Libonik

DREJTORISË SË PRONAVE- BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia" MALIQ

Për Dijeni : **DREJTORISË SË URBANISTIKËS**

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 " **Për Vetëqeverisjen Vendore**", kreu XI " **Drejtimi dhe funksioni i strukturave administrative të bashkisë**" , neni 65 " **Administrata e Njësisë Administrative**" , neni 66 " **Detyrat e administratës së njësisë Administrative**",

Në cilësinë e Administratores së njësisë Administrative Libonik , bazuar në kërkesat e banorëve dhe në konstatimet e kryera nga ana jonë, me anë të kësaj shkrese , kërkojmë nga ana juaj zhvendosjen e monumentit (**lapidar**) të gjendur në fshatin **Libonik**, për arsye të mos patjes akses si rrjedhojë e pozicionimit në disa pasuri private. Për motive të mbarëvajtjes së punës në njësi dhe komunitet kërkojmë zhvendosjen e këtij objekti në një destinacion tjetër.

Kërkojmë nga ana juaj bashkëpunimin duke na vendosur në dispozicion burimet e duhura njerëzore dhe materiale për kryerjen e kësaj procedure.

Në pritje të përgjigjes tuaj, paraprakisht ju falenderojmë.

Me respekt!

NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBONIK

Znj. Rudina BREGU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBONIK

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTETI | DATE 10/10/2025 | QËLLIMI: ZHVENDOSJE LAPIDARI

VENDNDODHJA

BASHKIA: MALIQ | DVASHK/ZVASHK KORCE | ZONA KADASTRALE: 2445 | NUMRI PASURISE 114/80 | INDEX HARTE: K-34-114 -(231-B)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: ARE | SIP.PASURISE= 76250m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT _ m2 | NUMRI KATEVE _ | NUMRI PEMEVE 0

X=560331.11
Y=4507802.2

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=560816.11
Y=4507802.2



X=560331.11
Y=4507487.2

SH 1:2500

X=560816.11
Y=4507487.2

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI		Nr PASURIE	228		
2	LINDJE		Nr PASURIE	228		
3	JUG		Nr PASURIE	_		
4	PERENDIM		Nr PASURIE	116/25		

REALIZOI PER BASHKINE MALIQ

EMRI:Mevlan LAME

NENSHKRIMI

MIRATOI

DREJTORI: Johand SULO

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

KRYETARI I BASHKISE:Gezim TOPCIU

NENSHKRIMI / VULA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-G

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P; HK

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve;K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastralc;

SHENIME TE VECANTA:

Lapidari i cili ndodhet tek pasuria nr.778, do të zhvendoset tek pasuria nr.114/80 (Pronar:Shteti).

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI :_____

NENSHKRIMI: _____

PLAN VENDOSJE E LAPIDARIT Sh:1:1000

